

15 Shtator 2026,
Prishtinë

Vendim i Bordit të FBK-së i datës 15.09.2026, Prishtinë

Shtyrja e afatit kalimtar për kategoritë e reja

Në përputhje me kompetencat e Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) që rrjedhin nga Statuti i FBK-së, përkatësisht neni 24, dhe pas shqyrtimit të kërkesave të pranuar nga klubet lidhur me afatin kalimtar për kategoritë e reja, Bordi i FBK-së vendos si në vijim:

1. Miratohet shtyrja e afatit kalimtar për kategoritë e reja deri më 30 shtator 2026.
2. Afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi vlen në mënyrë të njëjtë për të gjitha klubet anëtare të FBK-së dhe u mundëson atyre kompletimin e dokumentacionit dhe përfundimin e procedurave të regjistrimit të lojtarëve të kategorive të reja.
3. Shtyrja e afatit bëhet duke marrë parasysh se fillimi i ligave të kategorive të reja është planifikuar për datat 10/11 tetor 2026, me qëllim që klubet të kenë kohën e nevojshme për përfundimin e procedurave përkatëse, pa ndikuar në përgatitjet për fillimin e garave.
4. Autorizohet Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së që, pas miratimit të këtij vendimi, t'ua komunikojë atë të gjitha klubeve dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

Në emër të Bordit të FBK-së,
Arben FETAHU



Federata e Basketbollit të Kosovës

